

KËRKESË

Drejtuar: Këshillit të Njesisë së Qeverisjes Vendore Kthellë,

Kryetarit të Komunës Kthellë z. Prend LEKGEGAJ

Unë i nënshkruari Frrok Radaçi, banor i fshatit Perlat Qëndër, Komuna Kthellë, i datëlindjes xx/xx/xxxx, me numër Dokumenti Identifikues xxxxxxxxxxx dhe adresë Lagja Radac, kërkoj nga ana juaj të më jepni në përdorim një sipërfaqe pyjore në vendin e quajtur “Rrëza e shkëmbit”. Sipërfaqja pyjore e kërkuar nga ana ime, të cilën unë dhe familja ime e kërkojmë ta përdorim për plotësimin e nevojave tona, ka qenë përdorur tradicionalisht brez pas brezi nga nga trungu im familjar dhe ka kufij të dukshëm e të njohur nga banorët e tjerë.

Kërkesën time e bazoj në ligjin nr. 9385 dt. 04.05.2005 “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”, të ndryshuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 22, dt. 09.01.2008 “Për Përcaktimin e Procedurave dhe Kritereve të Administrimit të Pyllit Komunal”, pikat 16, 17.

Në kushtet e sotme, kur Shteti ka hartuar një Strategji Kombëtare për rimëkëmbjen dhe rehabilitimin e Pyjeve, unë si kryefamiljar, duke kërkuar të drejtën e përdorimit të kësaj prone marr, përsipër se:

- ✓ Do të krijoj kushte të favorshme për vënien e saj nën mbrojtje;
- ✓ Do të punoj që kjo sipërfaqe të rikthehet në natyralitetin e saj, duke më shërbyer për plotësimin e nevojave të familjes time, por edhe si një hapësirë natyrore për shtimin dhe zhvillimin e biodiversitetit, bazuar në rekomandimet e përcaktuara nga studimet tekiko-shkencore, siç është Plani i Menaxhimit të Pyjeve Komunale të Nj.Q.V Kthellë;
- ✓ Do të ndërtoj marrëdhënie pozitive, mirëkuptim të ndërsjelltë dhe bashkëpunim me përdoruesit fqinjë, komunën dhe me strukturat e tjera ligjore e nënligjore në fuqi;
- ✓ Do të shlyej të gjitha detyrimet fiskale që parashikon ligji në raste të tilla.

Duke shpresuar në plotësimin e kërkesës time,

Me respekt,

Kërkuesi

Frrok RADACI